



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 02, datë 15.01.2020

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z.Gjon Fusha**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
2. Z. Gjon Fusha do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, përkohësisht nga data 16.01.2020-15.04.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, z.Fusha do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Gjirokastrë.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Z. Gjon Fusha dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
SANDËR BEÇI

ANËTAR  
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
BESNIK CANI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

